

Në bazë të Ligjit për punë vullnetare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 85/2007, 161/2008 dhe 147/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 124/19 dhe 103/21) dhe Programit për Punë Vullnetare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 numër 02-2680/1 nga 29 maj 2024, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Fondacionin për Demokraci Westminster në kuadër të projektit "Praktikoni Demokracinë" të financuar nga Ambasada Britanike në Shkup, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për paraqitjen e kandidatëve për punë vullnetare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024

I. Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar të paraqiten në thirrjen publike në bazë të së cilës organizohet puna vullnetare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) për vitin 2024.

II. Kuvendi ka nevojë të angazhojë 20 vullnetarë, të cilët duhet t'i përmbushin këto:

a) Kushte / kualifikime të përgjithshme për kandidatët:

- 1) të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) të mos jenë në marrëdhënie pune;
- 3) të kenë të paktën arsim të lartë (cikli i parë) ose të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve në ciklin e parë ose të dytë të studimeve;
- 4) të kenë aftësi për të komunikuar me sukses;
- 5) të kenë aftësi për shprehje të mirë me shkrim dhe hulumtim dhe
- 6) të kenë iniciativë, analitikë dhe interaktivitet;

b) Kushte / kualifikime specifike për kandidatët:

- 1) njohuri të mira të gjuhës angleze dhe punë me kompjuter (MS Office, Word, MS Outlook, Internet) dhe
- 2) njohja e proceseve shoqërore (politike, juridike, ekonomike dhe sociale) në vend.

III. Puna vullnetare zgjat 6 (gjashtë) muaj, për të cilën çdo vullnetar nënshkruan kontratë të punës vullnetare.

IV. Vullnetarët e angazhuar gjatë punës vullnetare mbështesin punën e sektorëve dhe seksioneve në Shërbimin e Kuvendit.

V. Kandidatët e interesuar që dëshirojnë të paraqiten për punë vullnetare në Kuvend duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës, i cili përmban:

- 1) biografi të shkurtër;
- 2) letër motivuese;

3) kopje të certifikatës / diplomës për ata që kanë mbaruar arsimin e lartë, përkatësisht vërtetim nga fakulteti amë për vitin e studimeve të ndjekura, me sukses të arritur;

4) kopje të shtetësisë.

VI. Dokumentet e nevojshme kandidatët e interesuar mund ti dorëzojnë për:

1) Zyrën e protokollimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bulevardi "11 Tetori" numër 10, 1000 Shkup, ose

2) me formë elektronike në këtë email adresë: oglas@sobranie.mk

Me shenjë:

" Për thirrje publike për vullnetarë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut "

VII. Afati për dorëzimin e dokumenteve të nevojshme nga pika V e kësaj thirrjeje është 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes në ueb faqen e Kuvendit.

VIII. Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga Komisioni për Përzgjedhje dhe përzgjedhje e Vullnetarëve në Kuvend për vitin 2024, i formuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga pika V e kësaj thirrjeje. Kandidatët që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë thirrje do të njoftohen për kohën e zbatimit të intervistës në ambientet e ndërtesës së Kuvendit.

XI. Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga Komisioni për Përzgjedhje dhe Përzgjedhje të Vullnetarëve, bazuar në:

1) sukses i arritur në arsim;

2) pjesëmarrja në projekte, punëtori, programe studentore;

3) njohuri të përgjithshme për punën e Kuvendit dhe njohuri të përgjithshme në sferën e shkencave juridike, ekonomike, sociale dhe shkencave politike.

X. Me rastin e zgjedhjes së vullnetarëve që do të angazhohen për punë vullnetare, respektohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive dhe balastit gjinor.

XI. Informata plotësuese për kandidatët:

1) për periudhën e punës vullnetare, organizatori i punës vullnetare i siguron vullnetarit trajnimin e duhur;

2) për ofrimin e shërbimeve, njohurive dhe aftësive për çështjet në kompetencë të Kuvendit, vullnetarët e angazhuar kanë të drejtë në kompensim për shpenzimet e ushqimit dhe shpenzimet e transportit deri dhe nga vendi i vullnetarizimit në shumë deri në 15% të roges mesatare mujore në Republikë e paguar për vitin e kaluar;

3) pas përfundimit të vullnetarizimit, Fondacioni për demokraci të Vestminister dhe Kuvendi nuk marrin obligim për punësim të vullnetarëve;

4) njoftohen kandidatët se nga veb- lokacioni i Kuvendit www.sobranie.mk. mund të informohen për funksionin, kompetencat dhe punën e Kuvendit.

XII. Kjo thirje publike do të publikohet në eub-faqes së Kuvendit.

Numër____

-----2024
Shkup

SEKRETARE E PËRGJITHSHME E KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT
Marina Dimovska